INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS

Ndërlidhja e buxhetit të Kosovës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2021–2025)



Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

Nëntor 2026

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Ndërlidhja e buxhetit të Kosovës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2021–2025)

Nëntor 2026

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 3

1. Hyrje: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe konteksti i ekonomisë së Kosovës 4

2. Metodologjia 6

3. Gjetjet kryesore 7

4. Kufizime 13

5. Rekomandimet 14

Aneksi 1: OZHQ-të sipas viteve 15

Aneksi 2: Verifikimi i metodologjisë – Krahasimi me rezultatet e Malit të Zi 16

Aneksi 3: Verifikimi i metodologjisë – Klasifikimi sipas dy OZHQ-ve 17

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

Këndvështrimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura këtu u përkasin autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht këndvështrimet apo qëndrimet e Kombeve të Bashkuara, Ekipit të OKB-së në Kosovë apo Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij publikimi i takon ekskluzivisht Institutit GAP.

Përmbledhje ekzekutive

Kosova është zotuar vullnetarisht për zbatimin e kornizës së Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) përmes Rezolutës për OZHQ-të të vitit 2018 dhe Strategjisë së Zhvillimit të Kosovës 2030, e cila integron OZHQ-të në sektorët kryesorë. Ky raport ofron analizën e parë gjithëpërfshirëse të përputhshmërisë së shpenzimeve publike të Kosovës me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për periudhën 2021–2025. Ai klasifikon shpenzimet buxhetore të Kosovës sipas OZHQ-ve, me qëllim të kuptimit të kontributit të financimit publik në prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm. Për shkak të natyrës së përgjithësuar të të dhënave buxhetore në dispozicion, shpenzimet janë klasifikuar në nivel të OZHQ-ve dhe jo në nivel të objektivave specifike brenda secilit OZHQ. Financimi i ndërlidhur me OZHQ-të është vlerësuar si në nivel të përgjjithshëm për periudhën pesëvjeçare, ashtu edhe në baza vjetore për secilin OZHQ.

Ky raport tregon se Kosova ka ndarë gjithsej 13.4 miliardë euro për shpenzime të ndërlidhura me OZHQ-të gjatë periudhës pesëvjeçare 2021–2025, që përbën një mesatare prej 2.7 miliardë euro në vit. Mesatarisht, rreth 87% e gjithsej shpenzimeve buxhetore janë ndarë për aktivitete që kontribuojnë në financimin e OZHQ-ve. Ndarjet vjetore tregojnë një rritje graduale, nga 2.2 miliardë euro në vitin 2021 në 3.1 miliardë euro në vitin 2025. Në përgjithësi, gjithsej buxheti i alokuar për OZHQ-të përbënte mesatarisht rreth 28% të Bruto Produktit Vendor të Kosovës gjatë periudhës së analizuar.

Raporti tregon gjithashtu se financimi i OZHQ-ve është shumë i përqendruar në një numër të vogël objektivash. Rreth 82% e shpenzimeve totale të ndërlidhura me OZHQ-të janë alokuar për pesë objektiva: OZHQ 1 (Pa varfëri), OZHQ 16 (Paqe, drejtësi dhe institucione të forta), OZHQ 4 (Arsim cilësor), OZHQ 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) dhe OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie). Ndër këto, OZHQ 1 zë pjesën më të madhe të financimit, me një alokim të përgjithshëm prej 3.8 miliardë eurosh, kryesisht për pensionet, skemat e asistencës sociale dhe transferet e tjera sociale që mbështesin grupet në nevojë. OZHQ 16 renditet i dyti, me 2 miliardë euro, duke reflektuar shpenzimet për administratën publike, institucionet e drejtësisë dhe sistemet e qeverisjes. Arsimi, infrastruktura dhe shëndetësia përbëjnë gjithashtu fusha kryesore të shpenzimeve, me secilën prej tyre që ka marrë përkatësisht 1.6 deri në 1.9 miliardë euro gjatë periudhës pesëvjeçare. Në anën tjetër, disa OZHQ marrin financim të kufizuar. Këtu përfshihen OZHQ 5 (Barazi gjinore), OZHQ 10 (Zvogëlim i pabarazive), OZHQ 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm), OZHQ 13 (Veprim për klimën), OZHQ 15 (Jeta në tokë) dhe OZHQ 17 (Partneritet për objektivat), ku secili përbën më pak se 1% të gjithsej shpenzimeve të ndërlidhura me OZHQ-të.

Gjetjet e këtij raporti theksojnë rëndësinë e integrimit të perspektivës së OZHQ-ve në proceset buxhetore dhe të planifikimit të politikave në Kosovë, me qëllim sigurimin e niveleve dhe alokimit optimal të burimeve për arritjen e OZHQ-ve. Përveç kësaj, rezultatet dëshmojnë rëndësinë e të kuptuarit të shpërndarjes së shpenzimeve të ndërlidhura me OZHQ-të dhe krahasimit të tyre me vlerësime objektive të nevojave për financim për secilin OZHQ. Në veçanti, duke pasur parasysh përqendrimin e shpenzimeve në një numër të vogël OZHQ-sh, studiuesit dhe politikëbërësit duhet të vlerësojnë nevojat për financim të objektivave që në këtë raport rezultojnë të nënfinancuara, veçanërisht ato që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, barazinë gjinore dhe uljen e pabarazive. Në të njëjtën kohë, duke qenë se shpenzimet për OZHQ 1 (luftimin e varfërisë) përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të ndërlidhura me OZHQ-të, është e rëndësishme të sigurohet që këto shpenzime të jenë sa më efikase dhe efektive, për shembull përmes orientimit të transfereve sociale drejt grupeve më të cenueshme. Rritja e efikasitetit të shpenzimeve për luftimin e varfërisë do të krijonte hapësirë fiskale për Kosovën që të rialokojë buxhetin drejt OZHQ-ve që aktualisht marrin më pak financim. Së fundi, forcimi i koordinimit ndërmjet financimit publik dhe burimeve të tjera të financimit për zhvillim, përfshirë partnerët ndërkombëtarë dhe sektorin privat, do të mund të ndihmonte në mobilizimin e burimeve shtesë për mbështetjen e arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

1. Hyrje: Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe konteksti i ekonomisë së Kosovës

Në vitin 2015, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara miratuan, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, një marrëveshje për objektivat e reja globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Përmes kësaj marrëveshjeje u përcaktua agjenda 2030, e cila përfshin 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, 169 qëllime dhe 247 tregues, që duhet të zbatohen deri në vitin 2030. Këto OZHQ janë grupuar në pesë kategori kryesore, të njohura si "5 P-të": njerëzit (People), planeti (Planet), prosperiteti (Prosperity), paqja (Peace) dhe partneritetet (Partnerships). Temat kryesore që synon Agjenda 2030 janë: çrrënjosja e varfërisë dhe urisë; shoqëri paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse; luftimi i pabarazive brenda dhe ndërmjet shteteve; promovimi i të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore; mbrojtja e planetit dhe burimeve natyrore; si dhe arritja e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, rritjes së mirëqenies dhe punësimit të denjë për të gjithë.[1] Bazuar në këtë Agjendë, shtetet kanë synim të integrjnë OZHQ-ve në dokumentet e tyre strategjike kombëtare dhe në proceset buxhetore, me qëllim lehtësimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Kosova ka shfaqur vullnet për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi një Rezolutë[2] për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me qëllim angazhimin e komisioneve parlamentare dhe të Qeverisë në zbatimin e OZHQ-ve përmes miratimit të legjislacionit përkatës, dokumenteve strategjike dhe sigurimit të buxhetit të nevojshëm. Për më tepër, në vitin 2023, Kosova miratoi Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030, e cila fokusohet në katër shtylla kryesore: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, zhvillimin njerëzor të barabartë, sigurinë dhe sundimin e ligjit, si dhe qeverisjen e mirë. Secila prej këtyre fushave përmban objektiva zhvillimore, të cilat më pas kategorizohen sipas sektorëve dhe objektivave specifike. Strategjia gjithashtu përcakton ndërlidhjen e secilit objektiv me OZHQ-të, duke dëshmuar angazhimin e Kosovës ndaj Agjendës 2030. [3] Megjithatë, ndonëse qeveria raporton në baza vjetore për zbatimin e objektivave të kësaj Strategjie, nuk ekziston një mekanizëm specifik për matjen e progresit të Kosovës drejt arritjes së OZHQ-ve.

Gjatë periudhës 2021–2025, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme, me një rritje të lartë reale të PBB-së pas pandemisë në vitin 2021, prej 10.7%, ndërsa gjatë katër viteve pasuese rritja reale mesatare ishte rreth 4%.[4],[5] Shkalla e papunësisë në Kosovë ka shënuar rënie të vazhdueshme gjatë periudhës 2021–2024. Nga 22.5% në vitin 2021, papunësia ra në 12.3% në vitin 2022, duke vazhduar trendin rënës në 10.9% në vitin 2023 dhe 10.8% në vitin 2024. Ndërkohë, inflacioni ka shënuar luhatje të konsiderueshme gjatë pesë viteve të fundit. Nga 3.3% në vitin 2021, ai u rrit ndjeshëm në 11.6% në vitin 2022, si pasojë e presioneve globale inflacioniste të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Kjo goditje nga inflacioni nxiti qeverinë të ndërmerrte masa shtesë mbështetëse për familjet dhe bizneset, të cilat kontribuuan në rritjen e shpenzimeve, veçanërisht në fushën e mbrojtjes sociale dhe subvencioneve. Në vitet pasuese, inflacioni u ul gradualisht, në

1 Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Qasur më 6 mars 2026
2 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Rezolutë për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Qasur më 6 mars 2026
3 Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030. Qasur më 6 mars 2026
4 Për vitin 2025, PBB-ja reale është llogaritur duke deflatuar projeksionin e PBB-së nominale me normën e inflacionit, sipas formulës: PBB reale = PBB nominale / (1 + inflacioni).
5 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Llogaritë Kombëtare. Qasur më 6 mars 2026

4.9% në vitin 2023 dhe më tej në 3.9% në vitin 2025. Shpenzimet publike gjatë kësaj periudhe u ndikuan ndjeshëm nga rimëkëmbja ekonomike pas pandemisë, presionet inflacioniste dhe rritja e shpenzimeve qeveritare. Pas pandemisë COVID-19, aktiviteti ekonomik u rimëkëmb fuqishëm, i nxitur kryesisht nga konsumi privat, remitencat dhe shpenzimet publike. Rritja e aktivitetit ekonomik solli rritje të të hyrave tatimore, veçanërisht nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe doganat, duke i mundësuar Qeverisë të zgjerojë alokimet buxhetore në disa sektorë. Shpenzimet buxhetore u rritën në mënyrë të vazhdueshme nga 2.3 miliardë euro në vitin 2021 në 3.6 miliardë euro në vitin 2025. Shpenzimet rrjedhëse përbëjnë komponentin më të madh, duke zënë mesatarisht rreth 77% të shpenzimeve totale gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, shpenzimet kapitale kanë shënuar rritje të konsiderueshme, nga 424 milionë euro në vitin 2021 në 931 milionë euro në vitin 2025, duke përbërë mesatarisht 24% të shpenzimeve totale.[6] Shpenzimet faktike buxhetore arritën në 2.3 miliardë euro në vitin 2021 dhe në 3.1 miliardë euro në vitin 2024.[7] Në mënyrë të ngjashme, të hyrat buxhetore kanë shënuar rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2021–2025, duke u rritur nga 2.2 miliardë euro në vitin 2021 në 3.3 miliardë euro në vitin 2025.[8] Të hyrat tatimore përbëjnë pjesën më të madhe, me rreth 89% të të hyrave totale gjatë të gjitha viteve, ndërsa të hyrat jotatimore përbëjnë rreth 10% dhe grantet dhe ndihmat pjesën më të vogël, me më pak se 3% në shumicën e viteve.[9] Të hyrat faktike kanë qenë pak më të ulëta gjatë kësaj periudhe, duke rezultuar në një deficit buxhetor mesatar prej 0.4% deri në vitin 2024.

Figura 1. Deficiti fiskal i Kosovës, 2021–2024





Figura 2. Borxhi publik i Kosovës, 2021–2025



Burimi: Llogaritjet e Institutit GAP, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Të hyrat e buxhetuara nuk mbulojnë nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të buxhetuara, ndërsa nevojat mesatare vjetore për financim janë rreth 350 milionë euro. Këto nevoja financiare mbulohen përmes borxhit publik, të brendshëm dhe të jashtëm, i cili gjatë pesë viteve të fundit ka arritur një vlerë mesatare prej rreth 1.7 miliardë eurosh. Si përqindje e PBB-së, borxhi publik i Kosovës konsiderohet i ulët, me një mesatare prej 18% të PBB-së gjatë periudhës 2021–2025. Përqindja më e lartë u regjistrua në vitin 2021 (21.1%), si rezultat i shpenzimeve të paplanifikuara për menaxhimin e pandemisë, ndërsa përqindja më e ulët u regjistrua në vitin 2025 (16.4%). Përveç kësaj, remitencat nga diaspora luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e ekonomisë së Kosovës dhe kanë shënuar trend rritës gjatë periudhës 2021–2025. Ato kanë arritur një vlerë mesatare vjetore prej rreth 1.30 miliardë eurosh, që përbën afërsisht 13%

6 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ligji për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për 2021, 2022, 2023, 2024, 2025. Qasur më 6 mars 2026

7 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Thesari i Kosovës. Raportet vjetore financiare. Qasur më 6 mars 2026.


8 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ligji për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për 2021, 2022, 2023, 2024, 2025. Qasur më 6 mars 2026.

9 Ibid.

të PBB-së.[10] Këto transfere mbështesin ekonominë duke rritur të ardhurat dhe konsumin e familjeve, si dhe kontribuojnë në stabilitetin financiar përmes rritjes së likuiditetit.

Gjatë analizimit të shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit funksional, vërehet se shpenzimet më të larta janë alokuar për mbrojtjen sociale (e cila përfshin subvencionet dhe transferet), duke arritur në 867 milionë euro në vitin 2025. Kategoria e dytë me shpenzimet më të larta është çështjet ekonomike, e cila përfshin shpenzimet kapitale, subvencionet, pagat, si dhe mallrat dhe shërbimet, me një vlerë prej 655 milionë eurosh në vitin 2025. Edhe shërbimet e përgjithshme publike përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore, me 554 milionë euro në vitin 2025, ndërsa shpenzimet për arsim dhe shëndetësi mbeten mesatarisht në nivelin prej 380 milionë eurosh dhe 311 milionë eurosh, përkatësisht, gjatë periudhës pesëvjeçare.

Figura 3. **Shpenzimet buxhetore sipas kategorive funksionale (2021–2025)**



Burimi: Platforma e buxhetit e Institutit GAP, duke përdorur të dhëna nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ky raport synon të klasifikojë shpenzimet buxhetore të Kosovës të alokuara për OZHQ-të relevante për Kosovën, duke i analizuar dhe renditur ato sipas klasifikimit institucional, funksional dhe ekonomik. Qëllimi është të ofrojë, për herë të parë, një pasqyrë të përgjithshme të masës në të cilën shpenzimet buxhetore të Kosovës kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve, si dhe të identifikojë OZHQ-të që kanë përparësi në alokimin e burimeve publike. Raporti mbulon një periudhë pesëvjeçare, nga 2021 deri në 2025, dhe paraqet vlerat e shpenzimeve si për periudhën e konsoliduar pesëvjeçare, ashtu edhe në baza vjetore për secilin vit. Për më tepër, bazuar në gjetjet e raportit, Instituti GAP ofron një sërë rekomandimesh.

2. Metodologjia

Të dhënat e analizuara në këtë raport janë të dhëna buxhetore të mbledhura nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Kosovë dhe janë publikisht të disponueshme në Ligjin për Ndarjet Buxhetore të Kosovës për secilin vit përkatës. Më konkretisht, të dhënat përfshijnë të gjitha shpenzimet e buxhetuara për secilin vit gjatë periudhës pesëvjeçare 2021–2025. Për të siguruar konsistencë me vitet paraprake, në shpenzimet e buxhetuara janë bërë disa përshtatje për të marrë parasysh ndryshimet në klasifikimin e kodeve buxhetore ndërmjet viteve të ndryshme fiskale. Me evoluimin e strukturës buxhetore të Qeverisë, kodet e

10 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Seritë Kohore. Qasur më 6 mars 2026.


programeve dhe klasifikimet institucionale rishikohen periodikisht, gjë që mund të ndikojë në mënyrën se si kategorizohen shpenzimet nga njëri vit në tjetrin. Për të siguruar krahasueshmëri përgjatë periudhës pesëvjeçare të analizuar, shpenzimet janë rialokuar bazuar në qëllimin e tyre përmbajtësor, dhe jo në klasifikimin e kodit të përdorur në ligjin e buxhetit të secilit vit. Kriteri kryesor i përdorur për klasifikimin e shpenzimeve ishte klasifikimi institucional. Përkatësisht, të gjitha shpenzimet e institucioneve (p.sh. ministrive, agjencive dhe institucioneve të tjera publike) që operojnë kryesisht në një sektor të caktuar, si arsimi, shëndetësia ose mjedisi, janë përcaktuar në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) që lidhet më së shumti me atë sektor. Në rastet kur një institucion vepron në disa sektorë, vetëm shpenzimet e departamenteve ose njësive përkatëse janë alokuar në OZHQ-në përkatëse. Çdo kategori shpenzimi është klasifikuar në një OZHQ të vetëm, i cili është konsideruar më i ndërlidhuri me atë shpenzim, megjithëse disa shpenzime mund të kontribuojnë potencialisht në më shumë se një OZHQ. Kategoritë buxhetore që nuk ishin të lidhura drejtpërdrejt me ndonjë OZHQ janë përjashtuar nga raporti. Shpenzimet që nuk lidhen me OZHQ-të përfshijnë shërbimet ushtarake dhe të inteligjencës, shërbimet e punëve të jashtme, departamentet e administratës dhe financave, shërbimet e prokurimit dhe shpenzimet e kabineteve politike. Këto shpenzime që nuk lidhen drejtpërdrejt me OZHQ-të përbëjnë përgjithësisht 10–11% të shpenzimeve vjetore gjatë periudhës pesëvjeçare.

Për shkak të natyrës së përgjithësuar të të dhënave buxhetore në dispozicion, shpenzimet janë klasifikuar në nivel të OZHQ-ve, dhe jo në nivel të objektivave specifike të secilit OZHQ. Financimi i ndërlidhur me OZHQ-të është vlerësuar si në totalin kumulativ për periudhën pesëvjeçare, ashtu edhe në baza vjetore për secilin OZHQ.

3. Gjetjet kryesore

Rezultatet tregojnë se Kosova ka alokuar gjithsej 13.4 miliardë euro për financimin e ndërlidhur me OZHQ-të gjatë periudhës pesëvjeçare 2021–2025. Mesatarisht, rreth 2.7 miliardë euro në vit janë alokuar për financimin e OZHQ-ve.

Figura 4. **Shpenzimet totale buxhetore kundrejt buxhetit total për OZHQ-të (2021–2025)**




Burimi: Llogaritjet e Institutit GAP duke përdorur të dhënat e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

Ndarjet buxhetore vjetore tregojnë një trend në rritje, me nivelin më të ulët të regjistruar në vitin 2021, prej 2.2 miliardë eurosh, dhe nivelin më të lartë në vitin 2025, prej 3.1 miliardë eurosh. Shpenzimet totale buxhetore të Kosovës kanë ndjekur një trend të ngjashëm rritës, duke filluar nga 2.4 miliardë euro në vitin 2021 dhe duke u rritur në 3.6 miliardë euro në vitin 2025. Krahasimi ndërmjet

shpenzimeve të klasifikuara sipas OZHQ-ve dhe shpenzimeve totale buxhetore tregon se rreth 87% e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore janë alokuar për aktivitete që kontribuojnë në financimin e OZHQ-ve.

Buxheti total i ndarë për OZHQ-të përbënte mesatarisht 28% të PBB-së së Kosovës gjatë periudhës 2021–2025. Përqindja më e ulët u regjistrua në vitin 2022, me rreth 27%, ndërsa më e larta në vitin 2023, me rreth 29%.


Figura 5. Gjithsej buxheti për OZHQ si % e BPV (2021–2025)



Burimi: Llogaritjet e Institutit GAP bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Nga gjithsej buxheti i alokuar për OZHQ-të gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, rreth 82% është përdorur për financimin e pesë OZHQ-ve: OZHQ 1, 16, 4, 9 dhe 3. OZHQ-ja me buxhetin më të lartë të alokuar është OZHQ 1 (Pa varfëri), me një shumë kumulative prej 3.8 miliardë eurosh, që përbën 28% të buxhetit total të alokuar për OZHQ-të. E dyta renditet OZHQ 16 (Paqe, drejtësi dhe institucione të forta), me një buxhet prej 2 miliardë eurosh gjatë periudhës pesëvjeçare, që përbën 15% të buxhetit total të alokuar për OZHQ-të. Tre OZHQ-të e tjera që përbëjnë mesatarisht 13% të buxhetit total për OZHQ-të janë: OZHQ 4 (arsim cilësor), OZHQ 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) dhe OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie). Në të kundërt, gjashtë OZHQ – OZHQ 10 (Zvogëlim i pabarazive), OZHQ 17 (Partneritet për objektivat), OZHQ 13 (Veprim për Klimën), OZHQ 15 (Jeta në tokë), OZHQ 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm) dhe OZHQ 5 (Barazi gjinore) – kanë secili një buxhet të alokuar prej më pak se 1% të buxhetit total për OZHQ-të.

Figura 6. Shpenzimet totale buxhetore të klasifikuara sipas OZHQ-ve (kumulative)




Burimi: Llogaritjet e Institutit GAP bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Gjatë analizimit të shpenzimeve për secilin OZHQ në baza vjetore, të dhënat tregojnë se OZHQ 1 (Pa varfëri) mbetet kategoria me shpenzimet më të larta përgjatë periudhës 2021–2025. Alokimi buxhetor për OZHQ 1 u rrit gradualisht nga 642 milionë euro në vitin 2021 në 906 milionë euro në vitin 2025, me rritje më të theksuar në vitin 2023 (+11.4%) dhe veçanërisht në vitin 2025 (+14.4%). Kjo tregon një prioritizim të vazhdueshëm të mbrojtjes sociale dhe masave që lidhen me

luftimin e varfërisë. Rritja në vitin 2023 erdhi si rezultat i rritjes së pensioneve dhe pakos për ringjalljen ekonomike, e cila synonte zbutjen e ndikimit të inflacionit. [11] Në vitin 2025, krahas rritjes së buxhetit për transferet sociale, u rrit edhe buxheti për skemën e punësimit "Superpuna".[12] OZHQ 16 (Paqe, drejtësi dhe institucione të forta) shënoi rritje të konsiderueshme në vitin 2022 (+16.9%), e shkaktuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve për shpronësime (+57 milionë euro). Në vitin 2023 pati një rënie të lehtë prej 1.4%, ndërsa shpenzimet rifilluan trendin rritës gjatë viteve 2024-2025. Shpenzimet për arsim (OZHQ 4) ndoqën një trend të qartë rritës, me një rritje veçanërisht të theksuar në vitin 2024 (+14.8%), duke tejkaluar shumicën e sektorëve të tjerë të mëdhenj gjatë atij viti.

Figura 7. **Shpenzimet buxhetore të klasifikuara sipas OZHQ-ve (në baza vjetore)**



Burimi: Llogaritjet e Institutit GAP, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Shpenzimet për OZHQ 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) kanë shënuar luhatje gjatë kësaj periudhe. Pas një rënieje të theksuar në vitin 2022 (-21.9%), ato u rritën ndjeshëm në vitin 2023 (+40.6%), kryesisht si rezultat i investimeve në infrastrukturën rrugore, duke shënuar një nga rritjet më të larta ndër kategoritë kryesore të shpenzimeve gjatë atij viti. Rritja vazhdoi edhe gjatë viteve deri në vitin 2025. Në mënyrë të ngjashme, OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie) shënoi rënie në vitin 2022 (-4.1%), por më pas pati një rritje të qëndrueshme në vitet 2023 dhe 2024, prej rreth 15% në secilin vit, përpara se të stabilizohej në vitin 2025. Ndër OZHQ-të me buxhet më të vogël, OZHQ 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme) shënoi një rritje veçanërisht të madhe në vitin 2024 (+37.2%), duke tejkaluar rritjen e shumicës së sektorëve të tjerë gjatë atij viti, përpara se të shënonte rënie në vitin 2025. OZHQ 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike) ka shfaqur luhatje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe. Filloi me një rritje të jashtëzakonshme në vitin 2022 (+186.9%), e cila vazhdoi edhe në vitin 2023 (+35.9%), por u pasua nga një renie e theksuar në vitin 2024 (-47.5%), e cili u kompensua pjesërisht në vitin 2025.

Gjithsej buxheti i alokuar për shpenzimet e klasifikuara nën OZHQ 1 (Pa varfëri) gjatë periudhës 2021–2025 ishte 3.8 miliardë euro. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre shpenzimeve është alokuar për skemën e pensioneve dhe programet e

11 Instituti GAP. 2022. Projektbuxheti 2023: Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve. Qasur më 6 mars 2026.
12 Instituti GAP. 2024. Projektbuxheti 2025: Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve. Qasur më 6 mars 2026.

asistencës sociale (përfshirë pakot për rimëkëmbjen ekonomike dhe ringjalljen ekonomike gjatë periudhës së pandemisë), të cilat ofrojnë transfere për të mbështetur të moshuarit dhe familjet në nevojë, si dhe kategori të tjera, përfshirë fëmijët dhe nënat në pushim të lehonisë. Këto masa kontribuojnë në reduktimin e varfërisë dhe sigurimin e një niveli bazë të sigurisë financiare. Buxheti gjithashtu mbështet shërbimet sociale dhe kujdesin rezidencial për të moshuarit, si dhe programin e banimit social, i cili synon përmirësimin e kushteve të banimit për familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet e tjera të cenueshme. Këto shpenzime kontribuojnë në arritjen e synimeve 1.1 dhe 1.2 të OZHQ 1, të cilat synojnë çrrënjosjen e varfërisë ekstreme dhe reduktimin e përqindjes së njerëzve që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj.

Sa i përket OZHQ 2 (Zero uri), Kosova ka alokuar një buxhet prej 403.1 milionë eurosh për financimin e aktiviteteve të ndërlidhura me këtë objektiv. Këto shpenzime zbatohen kryesisht nga Ministria e Bujqësisë dhe institucionet përkatëse, përfshirë Institutin e Bujqësisë së Kosovës, dhe fokusohen në forcimin e prodhimit bujqësor dhe mbështetjen e zhvillimit rural. Alokimet buxhetore përfshijnë subvencione dhe grante për fermerët, investime në infrastrukturën bujqësore, siç janë kanalet e ujitjes në komuna dhe fshatra, si dhe mbështetje për kërkimin dhe zhvillimin në bujqësi. Këto shpenzime kontribuojnë në arritjen e objektivave 2.3 dhe 2.4 të OZHQ 2, përmes rritjes së produktivitetit bujqësor dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme të bujqësisë. Ndërkohë, investimet në infrastrukturën rurale dhe institucionet bujqësore kontribuojnë edhe në objektiva 2.a, i cili synon forcimin e kapaciteteve prodhuese në sektorin e bujqësisë.

Ndarjet buxhetore për OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie) arritën në 1.6 miliardë euro gjatë periudhës 2021–2025. Këto shpenzime zbatohen kryesisht përmes Ministrisë së Shëndetësisë, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe drejtorive komunale të shëndetësisë. Ndarjet buxhetore fokusohen në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës spitalore, blerjen e pajisjeve mjekësore dhe automjeteve, si dhe financimin e shërbimeve shëndetësore. Këto investime synojnë përmirësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor dhe forcimin e kapaciteteve të sistemit shëndetësor, duke kontribuar në objektivin 3.8 për mbulimin shëndetësor universal, objektivin 3.c për forcimin e financimit të shëndetësisë dhe fuqisë punëtore në këtë sektor, si dhe 3.d për përmirësimin e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e rreziqeve shëndetësore.

Shpenzimet nën OZHQ 4 (Arsim cilësor) arritën në 1.9 miliardë euro gjatë kësaj periudhe, duke e bërë arsimin kategorinë e tretë më të madhe të shpenzimeve për OZHQ-të në buxhetin e Kosovës. Financimi zbatohet kryesisht përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universitetit të Prishtinës, Akademisë së Shkencave dhe Arteve, si dhe drejtorive komunale të arsimit. Alokimet buxhetore përfshijnë ndërtimin dhe rinovimin e objekteve shkollore dhe çerdheve, investimet në infrastrukturën universitare, si dhe financimin e institucioneve arsimore. Këto investime kontribuojnë në përmirësimin e qasjes në arsim cilësor dhe të mjediseve të të nxënit, duke mbështetur objektivat 4.1, 4.2 dhe 4.3 të OZHQ 4, të cilat lidhen me qasjen në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe objektiven 4.a, i cili fokusohet në sigurimin e objekteve arsimore të sigurta dhe gjithëpërfshirëse.

Kosova ka alokuar 2.8 milionë euro për OZHQ 5 (Barazi Gjinore) gjatë periudhës 2021–2025, duke përfaqësuar një nga pjesët më të vogla të shpenzimeve të ndërlidhura me OZHQ-të. Këto fonde zbatohen kryesisht përmes Agjencisë për Barazi Gjinore dhe zyrave komunale për barazi gjinore. Shpenzimet fokusohen

në iniciativa që synojnë promovimin e politikave për barazi gjinore, forcimin e mekanizmave institucionalë për adresimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave, si dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në jetën publike. Këto aktivitete kontribuojnë në arritjen e synimeve 5.1, 5.2 dhe 5.5 të OZHQ 5, të cilat fokusohen në eliminimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave, si dhe në promovimin e pjesëmarrjes së barabartë në proceset vendimmarrëse.

Sa i përket OZHQ 6 (Ujë i Pastër dhe Kanalizime), Kosova ka alokuar 282 milionë euro gjatë periudhës 2021–2025. Këto shpenzime zbatohen kryesisht përmes institucioneve si Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, si dhe programeve komunale të infrastrukturës. Investimet fokusohen në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë, sistemeve të kanalizimit, menaxhimin e shtretërve të lumenjve, si dhe projekte që lidhen me sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Këto aktivitete kontribuojnë në arritjen e objektivave 6.1 dhe 6.2 të OZHQ 6, të cilat synojnë sigurimin e qasjes në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizim, si dhe objektivave 6.4 dhe 6.6, të cilat fokusohen në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe mbrojtjen e ekosistemeve të ndërlidhura me ujin.

Kosova ka ndarë145 milionë euro për OZHQ 7 (Energji e përballueshme dhe e pastër) gjatë periudhës pesëvjeçare 2021–2025. Këto shpenzime zbatohen kryesisht përmes Ministrisë së Ekonomisë (Departamenti për energji) dhe Agjencisë për Efiçiencë të Energjisë, duke reflektuar përpjekjet për përmirësimin e qëndrueshmërisë energjetike. Ndarjet buxhetore fokusohen në masat e efiçiencës së energjisë, përfshirë izolimin e ndërtesave, instalimin e ndriçimit publik efiçient dhe përmirësimin e sistemeve të ngrohjes, si dhe në mbështetjen e projekteve për energjinë e ripërtërishme. Këto investime kontribuojnë në arritjen e objektivave 7.1, 7.2 dhe 7.3 të OZHQ 7, të cilat synojnë sigurimin e qasjes së besueshme në energji, rritjen e pjesës së energjisë së ripërtrishme në përzierjen energjetike, si dhe përmirësimin e efiçiencës së energjisë.

Gjatë periudhës 2021–2025, Kosova ka ndarë 658 milionë euro për OZHQ 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike). Shpenzimet zbatohen përmes institucioneve si Ministria e Financave, Agjencia e Punësimit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe drejtorive komunale për zhvillim ekonomik. Shpenzimet lidhen kryesisht me programet për zhvillimin ekonomik, promovimin e punësimit, regjistrimin e bizneseve, inovacionin dhe zhvillimin e turizmit. Këto iniciativa synojnë të nxisin ndërmarrësinë dhe krijimin e vendeve të punës, duke kontribuar veçanërisht në objektivat 8.2, 8.3 dhe 8.5 të OZHQ 8, të cilat fokusohen në rritjen e produktivitetit, mbështetjen e bizneseve dhe zgjerimin e mundësive për punësim.

Shpenzimet e ndërlidhura me OZHQ 9 (Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë) arritën në 1.7 miliardë euro gjatë periudhës 2021–2025, duke përfaqësuar një nga kategoritë më të mëdha të investimeve në kuadër të buxhetit të Kosovës të ndërlidhur me OZHQ-të. Buxheti është orientuar kryesisht në zhvillimin e infrastrukturës rrugore, sistemeve të transportit, si dhe ndërtimin e objekteve dhe hapësirave publike, të cilat përmirësojnë lidhshmërinë dhe mbështesin aktivitetin ekonomik. Këto investime kontribuojnë kryesisht në synimin 9.1 të OZHQ 9, i cili fokusohet në zhvillimin e infrastrukturës së besueshme, të qëndrueshme dhe rezistente, që mbështet zhvillimin ekonomik dhe përmirëson qasjen në shërbime.

Sa i përket OZHQ 10 (Zvogëlim i pabarazive), Kosova ka alokuar 67.1 milionë euro. Këto shpenzime zbatohen përmes Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, zyrave komunale për komunitete, si dhe institucioneve që ofrojnë shërbime sociale dhe ndihmë juridike falas. Buxheti mbështet programe që synojnë përfshirjen sociale

të komuniteteve pakicë, personave me aftësi të kufizuara dhe të rinjve, si dhe shërbime të tilla si ndihma juridike dhe nismat për integrimin e komuniteteve. Këto aktivitete kontribuojnë në arritjen e objektivave 10.2 dhe 10.4 të OZHQ 10, të cilat promovojnë përfshirjen sociale dhe politikat që synojnë reduktimin e pabarazive.

Shpenzimet nën OZHQ 11 (Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme) arritën në 685 milionë euro gjatë periudhës 2021–2025. Këto investime zbatohen përmes departamenteve përgjegjëse për planifikimin urban, kulturën, sportin, infrastrukturën dhe trashëgiminë kulturore, si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal. Financimi përfshin përmirësimin e infrastrukturës rrugore, projektet e zhvillimit urban, restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, ndërtimin e hapësirave publike dhe objekteve përkujtimore, si dhe komponentë të programit të banimit social. Këto shpenzime kontribuojnë në disa nga objektiva të OZHQ 11, përfshirë objektivat 11.1, 11.2 dhe 11.3, që lidhen me strehimin, transportin dhe planifikimin urban, si dhe synimin 11.4, i cili fokusohet në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kosova ka ndarë 11 milionë euro për OZHQ 12 (Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm) gjatë periudhës 2021–2025, duke përfaqësuar një pjesë relativisht të vogël të shpenzimeve totale të ndërlidhura me OZHQ-të. Këto fonde mbështesin kryesisht aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, përfshirë blerjen e kontejnerëve për mbeturina dhe përmirësimin e sistemeve të grumbullimit të mbeturinave. Këto investime kontribuojnë kryesisht në objektivën 12.5 të OZHQ 12, e cila fokusohet në reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave, riciklimit dhe praktikave të ripërdorimit.

Sa i përket OZHQ 13 (Veprim për Klimën), Kosova ka ndarë 56.8 milionë euro buxhet. Shpenzimet zbatohen kryesisht përmes departamentit për mjedis në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe shërbimeve emergjente. Ky buxhet mbështet masat për mbrojtjen e mjedisit, gatishmërinë për situata emergjente dhe aktivitetet e menaxhimit mjedisor, duke forcuar kapacitetet kombëtare për adresimin e rreziqeve mjedisore. Këto investime kontribuojnë në objektivat 13.1 dhe 13.2 të OZHQ 13, të cilat fokusohen në forcimin e qëndrueshmërisë dhe kapaciteteve për përballimin e rreziqeve që lidhen me klimën, si dhe në integrimin e veprimeve për klimën në politikat dhe planifikimin kombëtar.

Ndarjet buxhetore në kuadër të OZHQ 15 (Jeta në tokë) arrijnë në 20.6 milionë euro, duke e renditur këtë objektiv ndër tri kategoritë me alokimet më të ulëta buxhetore. Këto shpenzime zbatohen kryesisht përmes departamentit të pylltarisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e parqeve kombëtare dhe zonave të mbrojtura. Buxheti fokusohet në menaxhimin e pyjeve, mbrojtjen e ekosistemeve, ruajtjen e biodiversitetit dhe mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura natyrore, si dhe në iniciativa mjedisore që lidhen me mbrojtjen e kafshëve. Këto investime kontribuojnë në objektivat 15.1 dhe 15.2 të OZHQ 15, të cilat fokusohen në ruajtjen e ekosistemeve dhe promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Me një buxhet prej 2 miliardë eurosh, OZHQ 16 (Paqe, drejtësi dhe institucione të forta) përfaqëson kategorinë e dytë më të madhe të shpenzimeve për OZHQ-të në buxhetin e Kosovës gjatë periudhës 2021–2025. Financimi është shpërndarë në një gamë të gjerë institucionesh, përfshirë Kuvendin, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Brendshme (dhe Policinë), Ministrinë e Drejtësisë (dhe gjykatat), si dhe zyrat e kuvendeve komunale. Shpenzimet

fokusohen në forcimin e administratës publike, institucioneve të drejtësisë, sistemeve të tatimeve dhe doganave, shërbimeve të regjistrimit civil, si dhe sistemeve të qeverisjes digjitale. Këto investime kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes, transparencës dhe sundimit të ligjit, duke mbështetur disa nga objektivat e OZHQ 16, përfshirë objektivat 16.3, 16.5 dhe 16.6, të cilat fokusohen në qasjen në drejtësi, luftimin e korrupsionit dhe ndërtimin e institucioneve efektive dhe llogaridhënëse.

Kosova ka ndarë 62.6 milionë euro për OZHQ 17 (Partneritet për objektivat) gjatë periudhës 2021–2025. Këto shpenzime zbatohen kryesisht përmes Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe aktiviteteve që lidhen me marrëveshjet ndërkombëtare dhe bashkëfinancimin me donatorë. Shpenzimet përfshijnë bashkëfinancimin e projekteve të mbështetura nga donatorët, zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe detyrimet financiare që lidhen me marrëveshjet ndërkombëtare të huamarrjes. Këto aktivitete kontribuojnë në objektivin 17.3 të OZHQ 17, i cili fokusohet në mobilizimin e burimeve financiare dhe forcimin e partneriteteve ndërkombëtare për zhvillim.

4. Kufizime

Ekzistojnë disa kufizime që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve të këtij raporti. Së pari, OZHQ-të janë të ndërlidhura dhe ndërsektoriale. Shumë shpenzime publike mund të kontribuojnë njëkohësisht në disa OZHQ. Për shembull, investimet në infrastrukturë mund të mbështesin rritjen ekonomike, përmirësimin e qasjes në shërbime si shëndetësia dhe arsimi, si dhe zhvillimin rajonal. Megjithatë, për të ruajtur konsistencën metodologjike, në analizën e mësipërme secili zë i shpenzimeve është klasifikuar vetëm në një OZHQ. Për rrjedhojë, klasifikimi duhet të interpretohet si një përafrim i objektivit kryesor të shpenzimit, dhe jo si një pasqyrim gjithëpërfshirës i të gjitha ndikimeve që një shpenzim mund të ketë në OZHQ. Në Aneks është përdorur një qasje më fleksibile ndaj këtij klasifikimi, duke lejuar që zërat buxhetorë t'i adresojnë një ose dy OZHQ. Rezultatet e kësaj qasjeje alternative janë gjerësisht të ngjashme me ato të analizës kryesore. Kjo sugjeron se klasifikimi i secilit zë buxhetor në një OZHQ të vetme është një qasje e dobishme për qëllime analitike.

Së dyti, raporti pasqyron ndarjet buxhetore, dhe jo efektivitetin apo rezultatet e politikave. Nivelet më të larta të shpenzimeve nuk përkthehen domosdoshmërisht në rezultate më të mira zhvillimore. Cilësia e politikave, kapacitetet institucionale dhe efikasiteti i shpenzimeve publike luajnë rol thelbësor në përcaktimin nëse burimet financiare kontribuojnë në mënyrë efektive në arritjen e synimeve të OZHQ-ve. Prandaj, politikat e mirë-dizajnuara dhe mekanizmat efektivë të zbatimit janë po aq të rëndësishëm, nëse jo edhe më të rëndësishëm, sesa vetë niveli i alokimeve buxhetore.

Së fundi, është e rëndësishme të theksohet se financat publike përfaqësojnë vetëm një burim të financimit të përgjithshëm të OZHQ-ve. Arritja e OZHQ-ve mbështetet gjithashtu në burime nga sektori privat, donatorët ndërkombëtarë, partnerët zhvillimorë dhe ekonomitë familjare. Në rastin e Kosovës, burimet e financimit të jashtëm, si remitancat, investimet e huaja direkte dhe projektet zhvillimore të financuara nga donatorët, luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe social. Rrjedhimisht, shifrat e paraqitura në këtë raport duhet të interpretohen si pasqyrim vetëm i kontributit të buxhetit të qeverisë në financimin e OZHQ-ve, dhe jo si pasqyrim i totalit të burimeve të mobilizuara në ekonomi për zhvillim të qëndrueshëm.

5. Rekomandimet

Bazuar në rezultatet e këtij raporti, rekomandohen masat e mëposhtme për politika:

- Të ndërmerren hulumtime të mëtejshme për OZHQ-të që aktualisht kapin nivele relativisht të ulëta të financimit publik. Rezultatet tregojnë se disa objektiva, si OZHQ 5 (Barazi Gjinore), OZHQ 12 (Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm), OZHQ 13 (Veprim për Klimën), OZHQ 15 (Jeta në tokë), OZHQ 17 (Partneritet për objektivat) dhe OZHQ 10 (Zvogëlim i pabarazive), përbëjnë më pak se 1% të shpenzimeve totale të ndërlidhura me OZHQ-të. Ndërsa disa prej këtyre sektorëve mund të përfitojnë në mënyrë indirekte nga kategori të tjera të shpenzimeve, nivelet aktuale të ndarjeve buxhetore tregojnë se, në pamje të parë, mbrojtja e mjedisit, politikat për barazinë gjinore dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve mbeten të nënfinancuara krahasuar me fushat e tjera të politikave. Hulumtimet e mëtejshme që vlerësojnë nevojat për financimin e OZHQ-ve të nënfinancuara do të ndihmonin në përcaktimin nëse dhe në çfarë mase rritja e investimeve në këto fusha do të kontribuonte në qëndrueshmërinë afatgjatë mjedisore, përfshirjen sociale dhe forcimin e bashkëpunimit institucional të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë.
- Duke pasur parasysh se OZHQ-të janë ndërsektoriale dhe të ndërlidhura, institucionet qeveritare duhet t'i integrojnë objektivat e OZHQ-ve në proceset e hartimit të buxhetit dhe planifikimit të politikave. Më konkretisht, zërat buxhetorë duhet të ndërlidhen me objektivat përkatëse të OZHQ-ve. Gjithashtu, masat dhe aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimit për Zhvillim (plani afatmesëm i zbatimit të Strategjisë për Zhvillim) duhet të harmonizohen tërësisht me OZHQ-të përkatëse, pasi aktualisht janë të harmonizuara vetëm në 40%. Në këtë mënyrë, krijimi i një kuadri monitorimi që ndjek progresin drejt objektivave dhe treguesve të OZHQ-ve, së bashku me ndarjet buxhetore, do të mundësonte që vendimet për shpenzimet publike të lidhen më ngushtë me rezultate të matshme zhvillimore.
- Shpenzimet buxhetore nën OZHQ 1 (Pa varfëri), i cili përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të ndërlidhura me OZHQ-të, duhet të jenë më të targetuara dhe specifike. Një pjesë e madhe e këtyre fondeve shkojnë për pensione dhe transfere sociale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e grupeve të cenueshme dhe ruajtjen e stabilitetit social. Megjithatë, përmirësimi i mekanizmave të targetimit të këtyre transfereve mund të rrisë efektivitetin e tyre në reduktimin e varfërisë dhe pabarazisë. Forcimi i sistemeve për verifikimin e kritereve të përfitimit, zgjerimi i programeve që kombinojnë asistencën sociale me masat e aktivizimit në tregun e punës, si dhe orientimi i një pjese më të madhe të burimeve drejt familjeve më të cenueshme, do të rriste ndikimin e këtyre shpenzimeve.
- Duhet të forcohen mekanizmat e koordinimit ndërmjet qeverisë dhe donatorëve. Duke qenë se financat publike përbëjnë vetëm një pjesë të financimit të OZHQ-ve, Kosova mund të thellojë më tej partneritetet me donatorët ndërkombëtarë, institucionet zhvillimore dhe sektorin privat për të mbështetur investimet në fusha si veprimi ndaj ndryshimeve klimatike, tranzicioni energjetik dhe infrastruktura e qëndrueshme. Forcimi i këtyre partneriteteve do të ndihmonte në mobilizimin e burimeve shtesë dhe në plotësimin e përpjekjeve buxhetore të Qeverisë për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Aneksi 1: OZHQ-të sipas viteve


Tabela 1. Ndarjet buxhetore për OZHQ-të në Kosovë për periudhën 2021–2025

	2021		2022		2023		2024		2025	
SDGs	Shuma në EUR	%	Shuma në EUR	%	Shuma në EUR	%	Shuma në EUR	%	Shuma në EUR	%
SDG 1	641.9 mln euro	**29.0%**	691.3 mln euro	**29.1%**	770.2 mln euro	**27.4%**	791.8 mln euro	**27.5%**	905.9 mln euro	**28.9%**
SDG 2	62.3 mln euro	**2.8%**	73.6 mln euro	**3.1%**	86.9 mln euro	**3.1%**	88.9 mln euro	**3.1%**	91.5 mln euro	**2.9%**
SDG 3	288.9 mln euro	**13.0%**	277.0 mln euro	**11.7%**	320.9 mln euro	**11.4%**	367.4 mln euro	**12.7%**	380.2 mln euro	**12.1%**
SDG 4	319.1 mln euro	**14.4%**	329.2 mln euro	**13.9%**	364.2 mln euro	**12.9%**	418.2 mln euro	**14.5%**	447.8 mln euro	**14.3%**
SDG 5	0.4 mln euro	**0.0%**	0.4 mln euro	**0.0%**	0.6 mln euro	**0.0%**	0.7 mln euro	**0.0%**	0.7 mln euro	**0.0%**
SDG 6	47.2 mln euro	**2.1%**	39.9 mln euro	**1.7%**	59.5 mln euro	**2.1%**	73.8 mln euro	**2.6%**	61.9 mln euro	**2.0%**
SDG 7	8.2 mln euro	**0.4%**	11.0 mln euro	**0.5%**	89.0 mln euro	**3.2%**	19.1 mln euro	**0.7%**	17.8 mln euro	**0.6%**
SDG 8	53.5 mln euro	**2.4%**	153.4 mln euro	**6.5%**	208.5 mln euro	**7.4%**	109.5 mln euro	**3.8%**	133.2 mln euro	**4.2%**
SDG 9	320.5 mln euro	**14.5%**	250.3 mln euro	**10.5%**	351.8 mln euro	**12.5%**	364.1 mln euro	**12.6%**	416.7 mln euro	**13.3%**
SDG 10	10.9 mln euro	**0.5%**	12.2 mln euro	**0.5%**	10.5 mln euro	**0.4%**	14.9 mln euro	**0.5%**	18.6 mln euro	**0.6%**
SDG 11	99.6 mln euro	**4.5%**	109.4 mln euro	**4.6%**	129.8 mln euro	**4.6%**	178.0 mln euro	**6.2%**	168.6 mln euro	**5.4%**
SDG 12	0.8 mln euro	**0.0%**	3.3 mln euro	**0.1%**	4.2 mln euro	**0.2%**	1.4 mln euro	**0.0%**	1.3 mln euro	**0.0%**
SDG 13	10.0 mln euro	**0.5%**	9.2 mln euro	**0.4%**	9.9 mln euro	**0.4%**	14.3 mln euro	**0.5%**	13.6 mln euro	**0.4%**
SDG 15	3.3 mln euro	**0.1%**	3.4 mln euro	**0.1%**	2.7 mln euro	**0.1%**	6.0 mln euro	**0.2%**	5.3 mln euro	**0.2%**
SDG 16	339.6 mln euro	**15.3%**	396.9 mln euro	**16.7%**	391.2 mln euro	**13.9%**	422.4 mln euro	**14.6%**	463.1 mln euro	**14.8%**
SDG 17	10.0 mln euro	**0.5%**	14.8 mln euro	**0.6%**	12.6 mln euro	**0.4%**	13.1 mln euro	**0.5%**	12.0 mln euro	**0.4%**
Buxheti total për SDG-të	**2216.1 mln euro**		**2375.2 mln euro**		**2812.5 mln euro**		**2883.6 mln euro**		**3138.3 mln euro**	

Aneksi 2: Verifikimi i metodologjisë – Krahasimi me rezultatet e Malit të Zi

Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e metodologjisë së klasifikimit dhe për qëllime të kontrollit të cilësisë, ky raport krahason rezultatet për Kosovën me një ushtrim të ngjashëm për financimin e OZHQ-ve në Malin e Zi. Mali i Zi ka përdorur një metodologji të pavarur, por të përafërt, për alokimin e shpenzimeve buxhetore sipas OZHQ-ve për një periudhë gjashtëvjeçare, 2015–2020. Duhet të theksohet se periudhat e krahasuara buxhetore të të dyja vendeve janë të ndryshme, gjë që mund të ketë ndikuar në prioritetet e shpenzimeve. Analiza e shpenzimeve për OZHQ-të në Kosovë për periudhën 2021–2025 dhe në Malin e Zi për periudhën 2015–2020[13] tregon dallime të rëndësishme në prioritetet e alokimeve, pavarësisht se Kosova ka pasur një buxhet total më të lartë, prej 13.4 miliardë eurosh, krahasuar me 9.8 miliardë euro në Malin e Zi. Mali i Zi ka alokuar gati një të tretën e buxhetit të tij për OZHQ 1 (Pa varfëri), përkatësisht 32.0%, ndërsa Kosova ka alokuar 28.3% të buxhetit të saj për këtë objektiv. Dallimi më i madh vërehet te OZHQ 9 (Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë), ku Kosova ka alokuar 12.7% të buxhetit të saj, krahasuar me vetëm 1.0% në Malin e Zi, duke treguar një fokus më të madh të Kosovës në zhvillimin e infrastrukturës. Në mënyrë të ngjashme, Kosova ka alokuar 4.9% të buxhetit për OZHQ 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike), krahasuar me 1.4% në Malin e Zi.

Figura 8. **Financimi i OZHQ-ve në Malin e Zi (2015–2020) dhe Kosovë (2021–2025)**



Llogaritjet e Insitutit GAP duke përdorur të dhëna nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Kombet e Bashkuara në Malin e Zi

Mali i Zi ka treguar angazhim më të madh ndaj OZHQ 11 (Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme), duke alokuar 12.2% të buxhetit, krahasuar me 5.1% në Kosovë, si dhe ndaj OZHQ 10 (Zvogëlim i pabarazive), me 6.1%, krahasuar me vetëm 0.5% në Kosovë. Të dyja vendet kanë pasur një fokus të ngjashëm në OZHQ 16 (Paqe, drejtësi dhe institucione të forta), OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie) dhe OZHQ 4 (Arsim Cilësor), me alokime që variojnë afërsisht nga 12% deri në 15%. Veçanërisht, të dyja vendet kanë alokuar shumë pak fonde për OZHQ 5 (Barazi gjinore), si dhe burime minimale për objektivat klimatike dhe mjedisore (OZHQ 13, 14 dhe 15), duke sugjeruar se këto fusha mbeten të nënprioritizuara në të dyja ekonomitë. Ngjashmëria e përgjithshme e rezultateve të dy analizave të pavarura buxhetore sugjeron se metodologjia e përdorur në Kosovë ka qenë e qëndrueshme dhe e përshtatshme për klasifikimin e shpenzimeve sipas OZHQ-ve.

13 Organizata e Kombeve të Bashkuara në Mal të Zi. SDG Policy Brief 1: SDG financing Montenegro. Qasur më 6 mars 2026.

Aneksi 3: Verifikimi i metodologjisë – Klasifikimi sipas dy OZHQ-ve

Kjo tabelë paraqitet si një test, për të vlerësuar nëse klasifikimi i shpenzimeve buxhetore në më shumë se një OZHQ[14] ndryshon renditjen e përgjithshme të shpenzimeve sipas kategorive. Në ndryshim nga metodologjia e përdorur në pjesën kryesore të raportit, në këtë tabelë disa shpenzime buxhetore klasifikohen në më shumë se një OZHQ_. Rezultatet janë të ngjashme me ato të paraqitura në Tabelën 1 të Aneksit 1, duke treguar se edhe kur disa shpenzime klasifikohen në dy OZHQ_, struktura e përgjithshme mbetet e njëjtë, me disa OZHQ që vazhdojnë të kenë nivelet më të larta të shpenzimeve buxhetore të klasifikuara në to.

Tabela 2. Buxheti për OZHQ-të në Kosovë për periudhën 2021–2025

	2021		2022		2023		2024		2025	
SDGs	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%	Shuma	%
SDG 1	641.9 mln euro	**29.0%**	697.3 mln euro	**23.2%**	633.2 mln euro	**18.4%**	810.8 mln euro	**22.6%**	908.9 mln euro	**24.3%**
SDG 2	62.3 mln euro	**2.8%**	76.6 mln euro	**2.6%**	94.4 mln euro	**2.7%**	99.2 mln euro	**2.8%**	97.1 mln euro	**2.6%**
SDG 3	288.9 mln euro	**13.0%**	290.3 mln euro	**9.7%**	324.9 mln euro	**9.5%**	370.3 mln euro	**10.3%**	382.1 mln euro	**10.2%**
SDG 4	319.1 mln euro	**14.4%**	330.8 mln euro	**11.0%**	364.2 mln euro	**10.6%**	421.4 mln euro	**11.8%**	449. mln euro	**12.0%**
SDG 5	0.4 mln euro	**0.0%**	447,622 €	**0.0%**	.6 mln euro	**0.0%**	.7 mln euro	**0.0%**	.7 mln euro	**0.0%**
SDG 6	47.2 mln euro	**2.1%**	45.6 mln euro	**1.5%**	73. mln euro	**2.1%**	81.8 mln euro	**2.3%**	68.5 mln euro	**1.8%**
SDG 7	8.2 mln euro	**0.4%**	19.1 mln euro	**0.6%**	100.8 mln euro	**2.9%**	29. mln euro	**0.8%**	22.2 mln euro	**0.6%**
SDG 8	53.5 mln euro	**2.4%**	276.4 mln euro	**9.2%**	397.3 mln euro	**11.6%**	199.3 mln euro	**5.6%**	201.4 mln euro	**5.4%**
SDG 9	320.5 mln euro	**14.5%**	443.4 mln euro	**14.8%**	581.1 mln euro	**16.9%**	624.1 mln euro	**17.4%**	662.1 mln euro	**17.7%**
SDG 10	10.9 mln euro	**0.5%**	19.3 mln euro	**0.6%**	21.4 mln euro	**0.6%**	28.3 mln euro	**0.8%**	33.7 mln euro	**0.9%**
SDG 11	99.6 mln euro	**4.5%**	287.2 mln euro	**9.6%**	315.5 mln euro	**9.2%**	359. mln euro	**10.0%**	354.5 mln euro	**9.5%**
SDG 12	0.8 mln euro	**0.0%**	7.1 mln euro	**0.2%**	9.4 mln euro	**0.3%**	12.5 mln euro	**0.3%**	6.7 mln euro	**0.2%**
SDG 13	10.0 mln euro	**0.5%**	24.2 mln euro	**0.8%**	30.6 mln euro	**0.9%**	34.3 mln euro	**1.0%**	29.2 mln euro	**0.8%**
SDG 15	3.3 mln euro	**0.1%**	5.9 mln euro	**0.2%**	4.3 mln euro	**0.1%**	6.6 mln euro	**0.2%**	6.3 mln euro	**0.2%**
SDG 16	339.6 mln euro	**15.3%**	431.2 mln euro	**14.4%**	422.8 mln euro	**12.3%**	464.2 mln euro	**13.0%**	500. mln euro	**13.4%**
SDG 17	10.0 mln euro	**0.5%**	46.6 mln euro	**1.6%**	59.6 mln euro	**1.7%**	39.9 mln euro	**1.1%**	19.5 mln euro	**0.5%**
Buxheti total për SDG-të	**2216.1 mln euro**		**3001.5 mln euro**		**3432.9 mln euro**		**3581.5 mln euro**		**3741.7 mln euro**	

14 Duhet të theksohet se në këtë tabelë disa zëra të shpenzimeve u alokohen më shumë se një OZHQ-je, që do të thotë se të njëjtat shpenzime numërohen dy herë në totalin e buxhetit. Ky klasifikim përdoret vetëm si test i robustësisë në Aneks dhe nuk është pjesë e metodologjisë kryesore të raportit.

GAP INSTITUTE

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mesqeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Ndërlidhja e buxhetit të Kosovës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (2021–2025)

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE